

VENDIM
Nr. 811, datë 29.12.2017

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2018 PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 13, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të nenit 29, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit të shërbimit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2018, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Miratimin e buxhetit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2018, sipas shtojcave 2 e 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
 3. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Qëllimi i Politikës së Programit


Qëllimi kryesor i Politikës së Institucionit konsiston në përmirësimin e dhënies së shërbimeve nepermjet përfundimit të procesit të regjistrimit fillestar në të gjithë vendin, si dhe modernizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim automatizimin e shërbimeve, perditësimin e të dhënave dixhitale të karteles dhe hartës treguese të regjistrimit, duke garantuar informacionin e regjistruar mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri, nëpërmjet një sistemi të sigurt, efikas, bashkëkohor të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme.

OBJEKTIVAT

OBJEKTIVI 1: Regjistrimi Fillestar i Pasurive të Paluajtshme dhe Permiresim Perditësimi i të dhënave

OBJEKTIVI 2: Automatizimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

OBJEKTIVI 3: Ndertimi i infrastruktures se ZRPP nrm kompletimit të zrrp me pajisje elektronike, orendi, dhe rikonstruksionit të ambjentëve të ZRPP



SHTOJCA 2

Në 000/ lekë

BUXHETI 2018

Përshkrimi	Buxheti 2018	
	Të ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Të ardhura nga shërbimet	2,615,220	
Shpenzime personeli		815,604
Shpenzime korente		306,413
Investime		868,440
Fonde te lira për t'u shpërndarë gjatë vitit		520,063
Fondi rezervë		104,700
TOTAL	2,615,220	2,615,220
TEPRICA (1)-(2)		0

SHTOJCA 3

BUXHETI I VITIT 2018

Në 000/ lekë

Nr.	Emërtimi	Buxheti 2018
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	2,615,220
	Të ardhura nga tarifat e shërbimeve	1,634,458
	Fonde që parashikohet të trashëgohen nga viti 2017	876,061
	Fond rezervë i trashëguar	104,700
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	2,615,220
1	Shpenzime personeli	815,604
	Paga	674,079
	Kontribute për sigurime shoqërore	111,895
	Fondi i veçantë i pagave	29,630
2	Shpenzime operative	306,413
	Shpenzime të mirëmbajtjes e të tjera	306,413
3	Shpenzime kapitale	1,388,503
	Investime kapitale të brendshme	868,440
	Fonde të lira për t'u shpërndarë gjatë vitit	520,063
4	Fondi rezervë	104,700
	Fondi rezervë	104,700
	TE ARDHURA (-) SHPENZIME	0